

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6645
E shtunë, 2 korrik 2022
çmimi 0.40 €

FSK-së i shtohen edhe 17 oficerë të rinj

FAQE 4



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ÇEKIA MERR KRYESIMIN E KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN,
PARA VETES KA PESË PRIORITETE

FAQE 4-5

KOSOVA, PRITJE TË MËDHA PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE GJATË KRYESIMIT TË BE-së NGA ÇEKIA



Çekia nga e premtja ka marrë kryesimin e radhës të Këshillit të Bashkimit Evropian, periudhë kjo që do të zgjasë deri më 31 dhjetor 2022. Në kryesimin e saj gjashtëmuor, Çekia ka caktuar prioritetet e saj, ndërsa duke iu referuar Ballkanit Perëndimor, prioritetet mbeten përparimi në

negociatat për zgjerim të BE-së dhe mbështetja e procesit të anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE. Ndërkaq, sa i përket specifikisht Kosovës, Çekia prioritetet ka caktuar dialogun Kosovë - Serbi dhe çështjen e liberalizimit të vizave

AKTUALE



SHAIP KAMBERI RIZGJEDHET DEPUTET I KUVENDIT TË SERBISË

F. 3

KUVENDI I SHOQPËRISË MBLIDHET MË 7 KORRIK MBI GJENOCIDIN NË SREBRENICË

F. 3

RRETH 8 900 RASTE TË RAPORTUARA PËRMES APLIKACIONIT "LAJMËRO POLICINË"

F. 6

EKONOMI



LARGIMI VULLNETAR NGA PUNA, TELEKOMI: JANË EKZEKUTUAR PAGESAT PËR 302 ISH-PUNËTORË

F. 8

MCC-ja MIRATON MARRËVESHJEN E KOMPAKTIT ME VLERË 236.7 MILIONË DOLLARË PËR KOSOVËN

F. 8

SPORT



KOSOVA SIGURON MEDALJEN E GJASHTË NË LOJËRAT MESDHETARE, LORIANA FITON TË ARTËN

F. 10



MINISTRI LATIFI S'E PËRJASHTON KTHIMIN E MASAVE KUNDËR COVIDIT

FAQE 7



PSD-JA THËRRET PROTESTË PËR SHKARKIMIN E MINISTRI MURATI

FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+389 44 487 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Qeveria e Abazoviqit në rrezik

PODGORICË, 1 KORRIK - "Tradhti ndaj Malit të Zi, kapitullim i shtetit para Kishës Ortodokse Serbe, farsë..." Këto janë disa prej vlerësimeve të disa partive politike në Mal të Zi për një version të marrëveshjes themelore që rregullon marrëdhëniet e shtetit të Malit të Zi me Kishën. Reagimi më i ashpër ka qenë nga partitë që marrin pjesë në Qeverinë e Malit të Zi ose i ofrojnë asaj mbështetje politike në Kuvend: Partia Socialdemokrate (SDP) dhe Partia Demokratike e Socialistëve (DPS).

Kritikat janë përcjellë me paralajmërime se qeveria, e zgjedhur dy muaj më parë, mund ta humbasë mbështetjen në Kuvend, ku ka një shumicë prej vetëm tri votash. Ajo që kundërshtohet me të madhe në propozim-tekstin e marrëveshjes së qeverisë është pjesa që e njeh subjektivitetin e Kishës Serbe në Mal të Zi gjashtë shekuj më herët se atë të Kishës në Serbi. E njohur si Marrëveshja Themelore, ajo nënshkruhet me bashkësitë fetare për t'i rregulluar marrëdhëniet e ndërsjella pronësore dhe

juridike. Pas gati një dekade negociatash të pasuksesshme të qeverive të mëparshme, kryeministri aktual i Malit të Zi, Dritan Abazoviq, ka premtuar nënshkrim të shpejtë të marrëveshjes themelore me Kishën Ortodokse Serbe. Presidenti i Malit të Zi, Milo Gjukanoviq, hodhi poshtë mundësinë e një marrëveshjeje të afërt mes Qeverisë në Podgoricë dhe Kishës Ortodokse Serbe, duke u munduar kështu t'i ulë disi tensionet që kanë përfshirë shtetin ballkanik.



KE gati t'i nisë bisedimet me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë



BRUKSEL, 1 KORRIK - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula Von der Leyen, shprehet se komisioni është gati t'i nisë bisedimet me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë për rrugën drejt BE-së. "Telefonatë e mirë me kryeministrin Kovaçevski. Lajme të mirëseardhura që Maqedonia e Veriut dhe Bullgaria me mbështetjen e Francës janë afër një marrëveshjeje që merr parasysh interesat dhe shqetësimet. Komisioni Evropian është gati ta nisë procesin e shqyrtimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë për hapin e radhës në rrugën e tyre evropiane", ka shkruar Von Der Leyen në një postim në "Twitter". Të enjten presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka thënë


se mendon se është gjetur një zgjidhje kompromisi për kornizën e negociatave të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian, e cila do ta përfshinte edhe Bullgarinë. "Mendoj se kemi gjetur një zgjidhje kompromisi", tha ai, por pa dhënë detaje nëse bëhet fjalë për një propozim që është dhënë më herët nga Presidenca franceze apo tjetër. Qeveria e Maqedonisë e Veriut e ka hedhur poshtë propozimin fillestar të Presidencës franceze, duke thënë se ai nuk jep garanci për mbrojtjen e gjuhës, identitetit dhe historisë maqedonase. Bullgaria, tash e dy vjet, bllokoi nisjen e negociatave të anëtarësimit midis Maqedonisë së Veriut dhe

Bashkimit Evropian për shkak të disa mosmarrëveshjeve me Shkupin rreth gjuhës dhe historisë. Më 24 qershor Parlamenti i Bullgarisë ka votuar për heqjen e kësaj vetoje. Zyrtarë të BE-së konfirmuan se propozimi i ri merr parasysh shqetësimet e shprehura nga të dyja palët. Maqedonia e Veriut ka statusin e vendit kandidat për BE-në tash e 17 vjet dhe ka marrë dritën jeshile për t'i filluar bisedimet e anëtarësimit në vitin 2020. Data për fillimin e negociatave nuk është caktuar kurrë për shkak të vetos bullgare. Për pasojë, edhe Shqipëria ka mbetur pas, sepse disa shtete të BE-së nuk duan që ajo të ndahet nga paketa me Maqedoninë e Veriut.

Rusia nis dërgesat e drithërave nga territoret e pushtuara të Ukrainës

MOSKË, 1 KORRIK - Rusia konfirmoi se ka nisur dërgimin e drithërave nga territoret e pushtuara në Ukrainë. Një anije me 7000 tonë drithëra u largua të enjten nga porti i qytetit të pushtuar të Berdyanskut, sipas një zyrtari rajonal pro-rus. Prej muajsh Kievi e ka akuzuar Rusinë se po vjedh drithërat e saj nga jugu i vendit dhe po bllokoi eksportin nga portet, duke kontribuar në krizën ushqimore globale, diçka që Moska e ka mohuar vazhdimisht. Eksportet e grurit në Ukrainë kanë pësuar një rënie prej 43-përqindësh krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, sipas Ministrisë së Bujqësisë së Ukrainës, duke nënvizuar dëmin që i është shkaktuar sektorit kyç të

ekonomisë së vendit nga pushtimi rus. Bllokimi i porteve në Detin e Zi, një rrugë kyçe për anijet që transportojnë produktet ushqimore, kanë sjellë një rritje substanciale të çmimeve të produkteve ushqimore. Autoritetet ukrainase kanë bërë me dije se këtë vit vendi pritet të korrë 65 milionë tonë drithë dhe fara luledielli, krahasuar me 106 milionë në vitin 2021. Shkak për këtë rënie të prodhimit është humbja e një pjese të territorit ndaj Rusisë. Ministria e Bujqësisë në Ukrainë bëri me dije se fermerët në jug dhe lindje të Ukrainës kanë nisur tashmë t'i vjelin të korrat e 2022-shit.



PDK-ja dorëzon në Kushtetuese Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 KORRIK - Kryetari i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, ka dorëzuar të premtën në Gjykatën Kushtetuese Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK), i cili, sipas tij, bie ndesh me gjashtë nene të Kushtetutës së Kosovës.

Tahiri ka thënë se janë shumë çështje të cilat e bëjnë këtë projektligj të papajtueshëm me Kushtetutën nga njëra anë dhe të papranueshëm për shkak të mundësisë që krijon për ndërhyrje politike nga ana tjetër. "Ky ligj cenon rënd pavarësinë e gjyqësorit të Kosovës. Ky është një ligj që shtrinë ndikimin e politikës në këshillin prokurorial. Që nga themelimi i institucioneve të Republikës së Kosovës asnjëherë nuk kemi parë një tendencë të tillë për ta kapur

Këshillin Prokurorial të Kosovës. Ky ligj bie ndesh me gjashtë nene të Kushtetutës së Kosovës. Argumentimet të cilat i ka sjellë PDK-ja konsiderojmë se janë një bazë e mjaftueshme për ta nxjerrë në kundërshtim me Kushtetutën një ligj të tillë", ka thënë Tahiri.

Më tej, ai ka thënë se qeveria, përmes votimit të këtij ligji, e ka kapur sistemin e drejtësisë në dorë përmes Këshillit Prokurorial. "Në mes të dy leximeve nuk janë marrë në konsideratë as rekomandimet e Komisionit të Venecias. Prandaj, këto janë arsye shtesë pse ky ligj bie ndesh me Kushtetutën. Këtë ligj e degradon edhe përbërja politike e këtij Këshilli. Tash çdokush mund të bëhet anëtar i Këshillit Prokurorial. Mjafton të ketë mbështetjen e politikës. Pra, tash, Këshilli Prokurorial është i varur nga politika, respektivisht nga mazhoranca. Kjo është e papranueshme, në kundërshtim me Kushtetutën,



prandaj edhe jemi të bindur që një vendim të tillë do ta nxjerrë dhe konfirmoi edhe vetë Gjykata Kushtetuese", ka thënë

Tahiri. Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e ka dorëzuar të premtën në Gjykatën

Kushtetuese për interpretim ligjshmërinë e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Kuvendi i Shqipërisë mblidhet më 7 korrik mbi gjenocidin në Srebrenicë

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Kuvendi i Shqipërisë ka publikuar projekt-rezolutën e dorëzuar nga shumica qeverisëse për përkujtimin dhe nderimin e viktimave të gjenocidit në Srebrenicë për seancën që do të mbahet më 7 korrik.

Në projekt-rezolutën e dorëzuar nga një grup deputetësh të Partisë Socialiste konfirmohet qëndrimi i Shqipërisë se mohimi i gjenocidit të kryer ndaj popullatës boshnjake nga forcat serbe të Bosnjës përbën shkelje të ligjit ndërkombëtar.

Nismëtarët pohuan se projektrezoluta iu referohet tri rezolutave të miratuara nga Parlamenti Evropian në vitet 2005, 2009 dhe 2015.

Ndër të tjera, theksohet se dënohet fuqimisht çdo prirje



dhe veprim për të mohuar publikisht me qëllim ose jo, gjenocidin e kryer në Srebrenicë, fshehjen e motiveve, lëvdimin e autorëve, ideatorëve dhe mbështetësve të këtij gjenocidi.

Gjithashtu, konsiderohet i papranueshëm dhe tejet i rrezikshëm vazhdimi dhe përshkallëzimi i retorikës politike nacionaliste, nxitja e urrejtjes etnike si pasojë e

mohimit të gjenocidit të kryer në Srebrenicë, masakrave dhe krimeve të tjera kundër njerëzimit kryer në të gjithë hapësirën e ish-Jugosllavisë nga disa individë, grupe e aktorë politikë e mediaticë brenda e jashtë rajonit të Ballkanit.

Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar 11 rezoluta dhe deklarata për ngjarjet në Kosovë. Në dy prej tyre është përcaktuar qartë dënimi i gjenocidit serb në Kosovë.

Prej shumë vitesh Shqipëria është ndër vendet e pakta që nuk ka miratuar një rezolutë për ta dënuar gjenocidin serb në Srebrenicë.

Deputetë të opozitës, mbështetës të ish-kryeministrit Sali Berisha, u përpoqën pa sukses në mesin e muajit maj të përfshinin në punimet e

Kuvendit një projektrezolutë për Srebrenicën.

Deputetët socialistët penguan kalimin e saj në seancë plenare, me argumentin se kërkesa nuk po rrezohej prej temës, por për shkak të propozuesve të saj.

Deputetët socialistë u shprehën se nuk mund të pranenin propozime të tilla nga një person i shpallur non grata nga ShBA-ja si i korruptuar dhe minues i demokracisë, i njohur edhe si thyerësi i embargos ndaj Slllobodan Millosheviqit.

Projektrezoluta e dorëzuar sot pritet të miratohet në seancën plenare të 7 korrikut. Kreu i grupit parlamentar i PS-së ka njoftuar se kanë ftuar përfaqësues zyrtarë të Bosnjë-Hercegovinës që të jenë në Kuvend në seancën që mbahet më 7 korrik.

Shaip Kamberi rizgjedhet deputet i Kuvendit të Serbisë

PRISHTINË, 1 KORRIK - Shaip Kamberi, përfaqësues politik i shqiptarëve të Luginës së Preshevës, ka thënë se është zgjedhur deputet i Kuvendit të Serbisë pas zgjedhjeve që janë përsëritur të enjten në fshatin Tërnovc. Megjithatë, Komisioni Republikan i Zgjedhjeve të Serbisë nuk e ka konfirmuar ende.

Zgjedhjet parlamentare në Serbi janë mbajtur qysh më 3 prill, por rezultatet nuk

janë certifikuar ende, për arsye të përsëritjes së votimeve në fshatin Tërnovc si pasojë e disa parregullsive. Votimet e së enjtes kanë qenë përpjekja e pestë.

Votat e Tërnovcit kanë qenë përcaktuese për përfaqësimin e pakicës shqiptare - me një deputet - në Kuvendin e Serbisë.

Në zgjedhjet e 3 prillit shqiptarët e Luginës kanë garuar me dy lista - "Koalicioni i Shqiptarëve të

Luginës", i udhëhequr nga Shaip Kamberi, dhe "Alternativa për Ndryshim - Alternativa Demokratike Shqiptare", e udhëhequr nga Shqiprim Arifi.

Në zgjedhjet e parafundit parlamentare në Serbi, në qershor të vitit 2020, partitë shqiptare kanë qenë në një koalicion dhe kanë fituar tri mandate parlamentare.

Kamperi ka qenë edhe në dy mandate të tjera deputet në Kuvendin e Serbisë.





ÇEKIA MERR KRYESIMIN E KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN, PARA VETES KA PESË PRIORITETE

Kosova, pritje të mëdha për liberalizimin e vizave gjatë kryesimit të BE-së nga Çekia

Çekia nga e premtja ka marrë kryesimin e radhës të Këshillit të Bashkimit Evropian, periudhë kjo që do të zgjasë deri më 31 dhjetor 2022. Në kryesimin e saj gjashtëmuor, Çekia ka caktuar prioritetet e saj, ndërsa duke iu referuar Ballkanit Perëndimor, prioritetet mbeten përparimi në negociatat për zgjerim të BE-së dhe mbështetja e procesit të anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE. Ndërkaq, sa i përket specifikisht Kosovës, Çekia prioritetet ka caktuar dialogun Kosovë - Serbi dhe çështjen e liberalizimit të vizave

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 1 KORRIK - I ngarkuari me punë i Ambasadës së Çekisë në Kosovë, Pavel Bilek, dhe ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, kanë organizuar të premtën në Prishtinë ceremoninë e hapjes së Presidencës së Çekisë të Këshillit të Bashkimit Evropian, gjatë së cilës janë paraqitur prioritetet e Presidencës së Çekisë për gjashtë muajt e ardhshëm.

Motoja e Presidencës së Çekisë është "Evropa si detyrë: rimendo, rindërto, rifuqizo", e marrë nga titulli i fjalimit të

presidentit Vaclav Havel nga viti 1996, fjalim ky ku ai u bëri thirrje evropianëve që të marrin përgjegjësi për sfidat globale mjedisore, sociale dhe ekonomike dhe të udhëheqin përmes shembullit. "Republika Çeke po e merr Presidencën e Këshillit të Bashkimit Evropian në mes të pushtimit rus kundër Ukrainës që ka kapluar tërësisht situatën gjeopolitike në kontinentin tonë. Kjo na bën të rivlerësojmë shumë prej qasjeve dhe premisave tona aktuale", ka deklaruar Bilek.

Në njoftim thuhet se objektiv i përgjithshëm i Presidencës Çeke është të kontribuojë në krijimin e kushteve për sigurinë

dhe prosperitetin e BE-së në kuadër të vlerave evropiane të lirisë, drejtësisë shoqërore, demokracisë, sundimit të ligjit dhe përgjegjësisë mjedisore. "BE-ja duhet të përqendrohet në garantimin e sigurisë së bashku me NATO-n dhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të mënyrës së lirë të jetës dhe demokracisë liberale së bashku me Shtetet e Bashkuara, Mbretërinë e Bashkuar dhe shtetet e tjera demokratike jashtë BE-së", thuhet më tej në njoftim.

Pesë prioritetet e përgjithshme të Presidencës Çeke përfshijnë menaxhimin e krizës së refugjatëve ukrainas dhe

rimëkëmbjen e pasluftës, sigurinë energjetike, forcimin e kapaciteteve mbrojtëse dhe sigurinë kibernetike të Evropës, qëndrueshmërinë strategjike të ekonomisë evropiane dhe qëndrueshmërinë e institucioneve demokratike. Ballkani Perëndimor është ndër zonat prioritare të Presidencës Çeke, së bashku me Ukrainën, Indo-Paqësorin dhe Sahelin. Presidencja Çeke do të përqipet të arrijë përparim konkret në negociatat e zgjerimit të BE-së dhe ta mbështesë procesin e anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor. "Shumica e prioritetëve të Presidencës Çeke përkthehen në aktivitete konkrete të BE-së në Kosovë, duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës jetike, investimin në burimet e energjisë së gjelbër dhe të ripërtëritshme dhe në mënyra ekologjike të transportit, mbështetjen e digjitalizimit të mëtejshëm dhe sigurisë kibernetike, si dhe kontributin në zhvillim ekonomik,

konkurrueshmëri dhe qasje në tregun e BE-së", ka pohuar ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog.

Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian janë dy organet kryesore vendimmarrëse të BE-së. Këshilli përbëhet nga ministrat e qeverive të 27 shteteve anëtare të BE-së, të cilët takohen në dhjetë konfigurime të ndryshme për të negociuar, ndryshuar dhe miratuar ligjet e BE-së, për t'i bashkërenduar politikat e BE-së dhe për të lidhur marrëveshje ndërmjet BE-së dhe vendeve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare.

Kryeministri Albin Kurti, i cili ishte i pranishëm në këtë ceremoni, ka thënë se populli i Kosovës ka pritje të mëdha nga Republika Çeke dhe lidhshme të liberalizimit të vizave dhe për t'i dhënë fund izolimit të qytetarëve të Kosovës në Evropën kontinentale.

Në pritjen e organizuar me rastin e marrjes së Presidencës

Murati: Gjuha e përdorur ka qenë e gabuar. U kërkoj ndjesë luftëtarëve të UÇK-së

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka reaguar pas akuzave dhe kërkesave për shkarkimin e tij lidhur me deklaratat që kishte bërë para disa vjetësh për veteranët dhe luftën e UÇK-së. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka theksuar se gjuha e përdorur ka qenë e

gabuar. Murati u ka kërkuar ndjesë luftëtarëve të UÇK-së ndaj gjuhës që ka përdorur. "I përulem sakrificës së secilit dëshmor e kontributit të secilit ushtar të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ky është qëndrimi im. Shkrimet e para disa vjetëve kanë qenë nga mllefi me ata që asokohe me fryrjen e listave për përfitime

financiare e politike po shtrembëronin historinë e luftës dhe të vërtetën tonë kolektive. Ju siguroj se ato shkrime nuk kanë pasur synim ofendimin ndaj ushtarëve dhe dëshmorëve. E pranoj që gjuha e përdorur atëherë ka qenë e gabuar, prandaj u kërkoj ndjesë të gjithë luftëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të tyre", ka shkruar Murati.



PSD-ja thërret protestë për shkarkimin e ministrit Murati



PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Partia Socialdemokrate (PSD) do të organizojë protestë për të kërkuar dorëheqjen e ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati. Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka bërë me dije se protesta do të organizohet më 6 korrik në orën 19:00 në sheshin "Zahir Pajaziti". "Ministri Murati nuk ka vend në qeverisje përderisa nuk njeht vendin që UÇK-ja ka në historinë e Kosovës për çlirim. Lufta jonë për liri nuk filloi e as nuk vazhdoi duke e bërë kontabilitetin e numrave. Kjo qasje në thelb është kundër luftës

dhe nuk ka sens lirie. Kjo rrymë politike e lufton çlirimin. Për më tepër, kjo rrymë politike nuk e duron as tjetrin të ndryshëm prej tij. Ajo e sheh secilin narracion të nënshtrueshëm siç është vetë. Pra kemi të bëjmë me mendje të kolonizuara dhe tendenca totalitare", ka thënë Molliqaj, duke shtuar se kjo lë të kuptojë se lufta nuk ka përfunduar në rrafshin politik. "Fryma që sot dominon dhe e cila është e mishëruar në institucione, në krye me kryeministrin, është aktive dhe në sulm. Gjatë këtyre ditëve kemi parë deklaratimet skandalozë të ministrit Hekuran

Murati duke sulmuar, përbuzuar dhe denigruar luftën që ushtarët e UÇK-së kanë zhvilluar me aq shumë vullnet e mund", ka thënë Molliqaj, duke theksuar se Kosova, pavarësia e së cilës ka rrjedhojë pikërisht prej luftës guximtare të grave dhe burrave të UÇK-së, nuk mund të tolerojë që të ketë ministër dikë që përbuz të kaluarën për ta akomoduar ndërgjegjen e tij në të ardhmen. Por kjo nuk është e mundur. UÇK-ja është frymëzimi ynë për të ardhmen. Takohemi në sheshin 'Zahir Pajaziti' dhe përfundojmë te qeveria", ka thënë Molliqaj.

FSK-së i shtohen edhe 17 oficerë të rinj

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Në Kazermën "Adem Jashari", pas katër vjetësh studime akademike, ka diplomuar të premten gjenerata 2022 e kadetëve të Qendrës për Studime Universitare "Wesley Clark" e Akademisë së Mbrojtjes së FSK-së.

Në ceremoninë e diplomimit morën pjesë ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, komandanti i FSK-së, gjeneralletjnant Bashkim Jashari, personalitete të institucioneve politike, diplomatike, e ushtarake

vendore dhe ndërkombëtare, ushtarakë e zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, si dhe familjarë të kadetëve të diplomuar.

Me këtë rast, para të pranishmëve fjalim mbajti ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, i cili vlerësoi lart këtë të arritur jo vetëm për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në, por edhe për gjithë qytetarët e vendit, shtetin dhe institucionet e saj. Ai porositi oficerët e rinj që të gjitha njohuritë akademike dhe shkathësitë profesionale të fituara t'i orientojnë në shërbim

të forcës për ta avancuar edhe më shumë dedikimin e shenjtë për mbrojtjen e vendit, respektivisht lirisë, pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të tij.

Në kuadër të programit, përveç ndarjes së diplomave, u publikuan edhe emrat e instruktorit dhe kadetit më të dalluar. Kadeti më i dalluar për gjeneratën 2022 u shpall Korab Seferi, kurse instruktori më i dalluar togeri Premtim Shaqiri, të cilët pranuan medalje nga ministri Mehaj dhe gjeneral Jashari.



së Bashkimit Evropian nga Republika Çeke, Kurti ka theksuar se Kosova, si i vetmi kandidat potencial për Bashkimin Evropian që nuk ka aplikuar ende për anëtarësim në BE, gjithashtu pret me padurim për të punuar së bashku ngushtë në gjashtë muajt e ardhshëm, ndërsa përgatit aplikimin për anëtarësim në BE. Kryeministri Kurti ka potencuar se Kosova është lider rajonal në një sërë renditjesh ndërkombëtare për sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut.

Së fundmi RCC-ja ka publikuar Barometrin Ballkanik, i cili ka treguar se qytetarët e Kosovës kishin pritshmëritë më të mira për të ardhmen e tyre (49 %).

Kryeministri Kurti ka thënë se pritjet e tilla të qytetarëve tanë duhet të përputhen me përgjigjen pozitive të Bashkimit Evropian. "Kjo presidencë ka një agjendë sfiduese dhe ambicioze, duke përfshirë mbështetjen për Ukrainën, sigurinë energjetike, mbrojtjen dhe sigurinë kibernetike, qëndrueshmërinë ekonomike dhe mbrojtjen e vlerave tona të përbashkëta demokratike", ka deklaruar kryeministri Kurti.

E pranishme në këtë ngjarje ishte edhe presidentja Vjosa Osmani dhe ministrja e Jashtme Donika Gërvalla. Nga janari deri më 30 qershor kryesimin e Këshillit të BE-së e kishte Franca.



BE-ja: Kosova ka të drejtë t'i heqë targat KM

PRISHTINË, 1 KORRIK - Zëdhënësi i Bashkimit Evropian për çështje të politikës së jashtme dhe sigurisë, Peter Stano, ka theksuar se BE-ja ka qenë e njoftuar, por jo edhe e konsultuar nga autoritetet e Kosovës për planet për reciprocitet mbi targat e veturave që lëshojnë autoritetet e Serbisë në Kosovë. Megjithatë, shtoi ai, Kosova ka të drejtë të marrë një vendim të tillë. "Sipas marrëveshjeve nga dialogu për lirinë e lëvizjes, nga viti 2011 dhe 2016 Kosova ka të drejtë t'i heqë nga përdorimi targat KM. Por, është e rëndësishme që të jepet kohë e mjaftueshme për implementimin e këtij plani dhe që ai të përgatitet dhe zbatohet në konsultim të afërt me qytetarët dhe në përputhje me praktikën e mira evropiane", ka deklaruar Stano. Më 29 qershor Qeveria e

Kosovës ka miratuar vendimin për mundësinë e reregjistrimit të veturave me targat e qyteteve në Kosovë të cilat i lëshojnë autoritetet e Serbisë - në RKS (Republika e Kosovës). Bëhet fjalë për veturat me targat PR (Prishtinë), KM (Mitrovicë e Kosovës) GL (Gjilan), PZ (Prizren) e kështu me radhë.

Sipas vendimit, reregjistrimi i këtyre veturave do të fillojë më 1 gusht dhe do të zgjasë deri më 30 shtator. Qeveria, po ashtu, ka miratuar udhëzimin për kalimin e pikave kufitare me dokumente personale, sipas të cilit, të gjithë personat që kanë dokumente të lëshuara nga autoritetet e Serbisë, me të hyrë në territorin e Kosovës, duhet të pajisen me një certifikatë që i zëvendëson ato dokumente. Këto vendime kanë shkaktuar reagime të ashpra në Beograd.



Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se zyrtarët kosovarë po përgatisin "persekutimin" e popullatës serbe, por nuk ka paraqitur asnjë provë për këtë

pretendim. I dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, ka qenë në Beograd në ditën kur Qeveria e Kosovës ka marrë vendimet. Ai

ka vlerësuar se në marrëdhëniet midis Kosovës dhe Serbisë është krijuar një "situatë e re", e cila ka ndryshuar "planet dhe temat" e vizitës së tij.

KCSF-ja dhe USAID-i lansuan programin për angazhim qytetar në Mitrovicën e Veriut

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 1 KORRIK - Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) dhe Misioni i USAID-it në Kosovë kanë vazhduar takimet me qytetarët në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar që është lansuar të premtën në Mitrovicën e Veriut.

Qytetarë nga Mitrovica e Veriut, Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit u mblodhën me moton "Bashkë angazhohemi" në hapësirat e Kolegjit Ndërkombëtar për Biznes në Mitrovicë (IBCM), për të diskutuar mbi mundësitë e angazhimit dhe veprimeve të përbashkëta me qëllim të ndërtimit të komuniteteve më të forta dhe mjedise më të mira jetese për qytetarët që jetojnë në këtë rajon.

Drejtori ekzekutiv i KCSF-së, Taulant Hoxha, iu drejtua të pranishmëve në fjalën e tij hyrëse duke theksuar se nuk ka



shoqëri civile pa njerëzit dhe komunitetet. "Për një kohë të gjatë shoqëria civile në Kosovë ka qenë një term i rezervuar për organizatat joqeveritare dhe projektet me një datë përfundimi, më shumë sesa

për individët që janë pjesë e komunitetit tonë apo edhe ata që nuk shihen, por që mund të angazhohen dhe vetëm sa pasurojnë kolektivitetin tonë. Por nuk ka shoqëri civile pa njerëzit në komunitetet ku ne

jetojmë: shkollat që formësojnë arsimin dhe jetën tonë publike, bizneset dhe punëtorët që fuqizojnë lagjet dhe qytetet tona, institucionet që mund të krijojnë një rrugë për të ardhmen tonë, dhe secili

e secila, pra çdo qytetar, që dëshiron të tregojë se ka vlerë për të ofruar për shoqërinë", ka thënë Hoxha.

Programi për Angazhim Qytetar është një partneritet në mes të KCSF-së dhe USAID-it në Kosovë me qëllim që t'i japë shoqërisë civile një kuptim më të plotë dhe t'i transformojë komunitetet në komunitete ku përkatësia është mundësi dhe jo barrierë. Programi për Angazhim Qytetar është një iniciativë pesëvjeçare e zbatuar nga KCSF-ja në partneritet me USAID-in në Kosovë. Qëllimi kryesor i këtij partneriteti është të nxisë një kulturë aktivizimi që e bën jetën në lagjet dhe qytetet tona më të mirë, më të kujdesshme dhe kuptimplotë. Nëpërmjet punës së tij, ky program do të sjellë një numër të madh veprimesh të bazuara në tri shtylla thelbësore: angazhimi i komunitetit, besimi ndërshoqëror dhe zgjerimi dhe mobilizimi i burimeve.

Rreth 8 900 raste të raportuara përmes aplikacionit "Lajmëro policinë"

PRISHTINË, 31 KORRIK (ER) - Për ta lehtësuar bashkëpunimin, komunikimin e ndërsjellë me qytetarët dhe ofrimin e mundësisë për lajmërimin e rasteve të ndryshme në Policinë e Kosovës, kohë më parë është lansuar platforma digjitale "Lajmëro policinë". Deri në këtë fazë përmes këtij aplikacioni në Policinë e Kosovës janë raportuar rreth 8 900 raste të ndryshme që

ndërlidhen me trafikun rrugor, posedim të armëve, drogës, raste të dhunës, korrupsionit etj.

Policia e Kosovës ka falënderuar qytetarët për raportimin e rasteve të ndryshme dhe bashkëpunimin e ofruar për arritjen e objektivave të përbashkëta për garantimin e një sigurie të përgjithshme dhe i ka inkurajuar të gjithë pa dallim që

edhe më tutje rastet të raportohen pa hezitim dhe në mënyrën më të lehtë për ta, përfshirë këtu edhe lajmërimin e rasteve përmes aplikacionit "Lajmëro policinë".

Raportimi nga ana e qytetarëve përmes këtij aplikacioni ofron transparencë, konfidencialitet dhe anonimitet të plotë.

Ky aplikacion/platformë mund të shkarkohet në pajisjet mobile në shqip, serbisht dhe anglisht.



Ministri Latifi s'e përjashton kthimin e masave kundër Covidit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 KORRIK - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka thënë të premten se Kosova është vendi me shkallën më të lartë të vaksinimit kundër Covid-19 në mesin e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ai ka thënë se ekipet e vaksinimit kanë dhënë deri tash mbi 1.8 milion doza të vaksinës, ndërsa rreth 1 milion qytetarë kanë marrë së paku një dozë të vaksinës. "Ajo që kemi parë ditët e fundit, ku rastet e Covid-19 janë rritur, na dëshmon të gjithëve se pandemia nuk ka përfunduar dhe ne kemi ende rrugë për të bërë deri në fundin e saj. Variantet e reja dhe zbehja e kujdesit ndaj virusit përbëjnë një rrezik real për ne dhe familjet tona, sidomos për ata që nuk janë vaksinuar ende. Kjo mund të sjellë vështirësi të tjera për personelin shëndetësor dhe t'i kthejë pamjet dhe përjetimet e rënda në spitalet tona", ka thënë Latifi në mesazhin dhënë për opinionin.

Ai ka bërë thirrje që të rritet kujdesi ndaj virusit Covid-19 për ta evituar kthimin e kufizimeve të rënda, të cilat, sipas tij, nuk i do askush, por që në situata të caktuara imponohen. "Jemi në stinën e pushimeve verore dhe vendi ynë pret që në ditët dhe javët në vijim shumë mërgimtarë të vijnë në Kosovë për t'u bashkuar me familjet e tyre dhe për të ndarë momente gëzimi dhe përjetime të ndryshme me të gjithë ne. Ata do të vijnë në shtëpitë, familjet dhe në vendin e tyre të dashur dhe ne, si gjithmonë, i mirëpresim. Ju lusim që t'i shfrytëzoni mundësitë e ofruara në vendet prej nga vini dhe të vaksinoheni. Nëse s'e keni bërë këtë, do t'ju afrojmë çdo mundësi që vaksinën ta merrni në Kosovë, për të pasur pushime të rehatshme e të shëndetshme", ka deklaruar Latifi.

Ai ka theksuar se Kosova falë angazhimit të institucioneve dhe përkrahjes së miqve të saj ka vaksina të mjaftueshme për çdo qytetar që është apo që mund të vijë këtu. "Për të



gjitha moshat dhe kategoritë e popullatës. Por, kemi nevojë që thirrjes për vaksinim t'i përgjigjeni me përgjegjësi. Mos ta harrojmë faktin se,

përkundër suksesit të vaksinimit kundër Covid-19 në Kosovë, ka ende vende ku vaksinimi është i ulët. Prandaj, më të sigurt do të jemi vetëm

atëherë kur secili nga ne e bën atë që duhet bërë përballë virusit: zbatimin e masave të kujdesit dhe vaksinimit e plotë", ka thënë ministri Latifi.

MSh-ja shqyrton ecurinë e programit legjislativ për 2022-n



"Duhet të jemi më të shpejtë në kohë dhe më të mirë në përmbajtje të këtyre dokumenteve që kanë rëndësi dhe të cilat duhet të japin zgjidhje afatgjatë për sektorin e shëndetësisë dhe qëndrueshmërinë e tij", ka theksuar ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi

EPOKA
ERE

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 1 KORRIK - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka kryesuar të premten një punëtori me personat përgjegjës të grupeve

punuese për ligjet dhe udhëzimet administrative në kuadër të planit legjislativ të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2022 që po mbahet në Brezovicë.

Ministri Latifi ka thënë se angazhimi maksimal për hartimin e ligjeve dhe udhëzimeve administrative është pjesë e detyrimeve që i ka Ministria e Shëndetësisë. "Duhet të jemi më të shpejtë në kohë dhe më të mirë në përmbajtje të këtyre dokumenteve që kanë rëndësi dhe të cilat duhet të japin zgjidhje afatgjatë për sektorin e shëndetësisë dhe qëndrueshmërinë e tij", ka theksuar Latifi.

Ai i vlerësoi shumë të rëndësishme projektligjet në procedura të plotësimit ndryshimit dhe hartimit siç është Ligji për Shëndetësi, Ligji për Sigurime

Shëndetësore, Ligji për rregullimin e çmimit të barnave dhe ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, duke kërkuar nga përgjegjësit që ta rrisin dinamikën e punës.

Personat përgjegjës për hartimin e ligjeve dhe udhëzimeve administrative kanë paraqitur ecurinë dhe statusin aktual të dokumenteve, mundësitë që krijojnë ato, por edhe sfidat e këtij procesi.

Programi legjislativ i MSh-së për vitin 2022 përmban plotësimit-ndryshimin dhe hartimin e gjashtë projektligjeve dhe 18 udhëzimeve administrative, disa prej të cilave tashmë janë në fazën e konsultimeve publike. Punëtorja është mbështetur nga projekti i Shëndetësisë për Kosovën i Qeverisë së Luksemburgut LUX-DEV KSV/017.

BE-ja njeh certifikatat e vaksinimit kundër Covid-19 të Kosovës

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Sekretariati i EU Digital Certificate i Komisionit Evropian e ka njoftuar Ministrinë e Shëndetësisë se është konfirmuar

pranueshmëria e vendimit mbi ekuivalencën e certifikatës digjitale të vaksinës kundër Covid-19, e lëshuar nga Kosova në EU Digital certificate, me qëllim

lehtësimin e së drejtës së lëvizjes së lirë brenda shteteve të Bashkimit Evropian.

Pas publikimit në gazetën zyrtare të Bashkimit Evropian, vendimi hyn në fuqi dhe

certifikata digjitale e vaksinimit kundër Covid-19 e Kosovës do të jetë e lexueshme në pikat hyrëse dhe kontrolluese brenda shteteve të Bashkimit Evropian.



Nga ky muaj edhe për fëmijët e lindur në vitin 2014 mund të aplikohet për shtesat

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se që nga e premtdja është hapur aplikimi edhe për fëmijët e lindur nga 1 janari i vitit 2014 që të përfitojnë nga shtesat për fëmijë. Duke filluar nga ky muaj skema për shtesat për fëmijë do të zgjerohet gradualisht, duke shtuar nga një gjeneratë për çdo

muaj. “Pra, në muajin gusht do të shtohet gjenerata e fëmijëve të lindur në vitin 2013, në muajin shtator gjenerata e fëmijëve të lindur në vitin 2012, e kështu me radhë.

Rikujtojmë qytetarët se aplikimi i rregullt për shtesa për fëmijë bëhet nga nëna dhe se llogaria bankare do të jetë në emër të aplikueses, kurse aplikimi nga

babai apo kujdestari ligjor i fëmijës bëhet vetëm në raste specifike”, thuhet në njoftimin për medie.

Gjithashtu, vlen të theksohet se aplikimi për shtesa për fëmijë tashmë do të jetë vazhdimisht i hapur në platformën eKosova, kurse pagesa do të bëhet me datë 25, apo ditën vijuese të punës të çdo muaji.



MCC-ja miraton marrëveshjen e kompaktit me vlerë 236.7 milionë dollarë për Kosovën



PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka njoftuar se Bordi i Drejtorëve i Korporatës Amerikane Sfidat e Mijëvjeçarit (MCC) ka miratuar të premten kompaktin me vlerë 236.7 milionë dollarë. Siç ka shkruar Kurti në “Twitter”, ky është investimi më i madh në sektorin energjetik në Kosovë deri më sot. “Do të ndihmojë në vendosjen e themeleve për tranzicionin tonë energjetik. Falënderime të veçanta për të dy ekipet tona për punën e shkëlqyer, miqtë, partnerët dhe aleatët”, ka shkruar Kurti.

Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, teksa ka njoftuar për këtë vendim, ka thënë se është e nderuar që i ka udhëhequr negociatat. “Lajm fantastik nga MCC-ja sot. Bordi i Drejtorëve sapo miratoi kompaktin me vlerë 236.7 milionë dollarë, investimi më i madh në sektorin energjetik të Kosovës, një gur themel në tranzicionin tonë energjetik. Mirënjohës Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe ekipit të Kosovës. Krenar për ekipin e Kosovës. E nderuar që kam udhëhequr negociatat”, ka shkruar Rizvanolli në “Twitter”.

Largimi vullnetar nga puna, Telekom: Janë ekzekutuar pagesat për 302 ish-punëtorë

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Telekom i Kosovës ka bërë me dije se për përfundimin me sukses të procesit të ofertës “Pakot vullnetare dalëse” është ekzekutuar pagesa për 302 ish-punëtorë të TK-së që kanë pranuar vullnetarisht pakot e ofruara dhe kanë nënshkruar marrëveshje për ndërprerje të marrëdhënies së punës me ndërmarrjen.

Telekom i këtë vit ua ofroi mundësinë punëtorëve të vet me “pakot dalëse”.

Në pakot një parashihej që kushdo që ishte paraparë të dilte në pension në katër vjetët e ardhshme, të pensionohej para kohe dhe të përfitonte 60 për qind të pagës aktuale bruto në periudhën deri në pensionim, ndërsa pakoja e dytë ishte ofrimi i 24 pagave bruto për këdo që ndërpret kontratën vullnetarisht. “Duke qenë se

shumë prej jush, pas njoftimit tonë për përfundimin me sukses të procesit të Ofertës ‘Pakot vullnetare dalëse’, keni shprehur shqetësimet e disa ish-të punësuarve apo opinionit lidhur me kompensimin financiar të tyre, ju njoftojmë se dje, me datë 30/06/2022, është ekzekutuar pagesa për 302 ish-punëtorë të TK sh.a. që kanë pranuar vullnetarisht pakot e ofruara dhe kanë nënshkruar marrëveshje për ndërprerje të marrëdhënies së punës me ndërmarrjen tonë”, thuhet në njoftim. “Në vazhdim e gjeni tabelën me të dhënat për pagesën e ekzekutuar dje si dhe vlerat e përcaktuara të tatimit dhe kontributit pensional që ditëve në vijim do t’u paguhet këtyre punëtorëve (gjithsesi para datës 15 të muajit korrik’22)”, thuhet në njoftimin e Telekomit.



Kuvendi zgjedh Nexhat Kryeziun anëtar joekzekutiv në Bordin e BQK-së

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Kuvendi i Kosovës ka përzgjedhur të premten

Nexhat Kryeziun anëtar joekzekutiv në Bordin e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK).

Kryeziu mori 72 vota nga deputetët e legjislavitit përmes votës së fshehur, ndërsa Lulzim

Ismajli mori 5 vota, Nora Raci 1 votë, ndërsa Esida Bujupi asnjë votë.



Tre opsionet e Perëndimit përballë urisë globale të shkaktuar nga lufta në Ukrainë



“The Independent”

Më shumë shpesh sesa jo, gjëja e rëndësishme në një samit ndërkombëtar, është ajo që nuk adresohet. Për momentin, kjo është shumë e vërtetë për liderët e G7-ës. Ata po e injorojnë urinë globale, që po shfaqet si një pasojë tragjike e pushtimit rus të Ukrainës.

Për shkak të ndërprerjeve që ka shkaktuar lufta, minimi të ujërave ukrainase dhe bllokadës së portit të Odesës nga marina ruse, miliona ton drithë dhe vaj luledielli, që tani duhet të ushqenin njerëzit në Afrikë, Lindjen e Mesme dhe Azinë Jugore, ndodhen ende në magazinat ukrainase në pritje për t'u eksportuar ose u kalbur, vjedhur dhe transportuar drejt Rusisë.

Kur ka radhë buke në Ukrainë, kjo duhet të përbëjë një arsye për t'u shqetësuar. Perëndimi ka përpara tre opsione, që të gjitha të sikletshme dhe të rrezikshme. Opsioni i parë është të mos bëjmë asgjë. Dhe heshtja e dukshme pavarësisht nevojës për t'i dhënë fund krizës globale

të ushqimit nga G7, sugjeron se kjo është qasja më e preferuar. Në fakt, kjo qasje do të dënonte mijëra, në mos miliona njerëz nga më të varfrit, në vende nga Gana deri në Jemen. Si gjithnjë, ata që janë në fund të listës, do të jenë të parët që do të përjetojnë urinë. Por shumë të tjerë do t'i pasojnë, kur inflacioni i lartë t'i përjashtojë nga tregu.

Kjo është një perspektivë e tmerrshme, e përkeqësuar më tej nga informacionet se të korrat e ardhshme do të jenë rreth gjysma e sasisë aktuale, për shkak të luftës që vazhdon në Ukrainë. Moti i keq dhe të korrat e dobëta gjetkë në botë, mund ta përkeqësojnë më tej këtë krizë.

Në çdo rast, ajo duket e destinuar të përkeqësohet. Përveç krizës së menjëhershme humanitare, një destabilitet i tillë në zona të gjera, që përfshijnë vende me të ardhura të ulëta dhe në zhvillim, do të shkaktojë trazira, do të ndezë konflikte, dhe do të rrisë flukset migratore drejt Perëndimit. Me kalimin e kohës presioni global për të bërë diçka për të

mbushur barkun me bukë, do ta detyrojë botën e pasur të veprojë. Por për disa do të jetëshumë vonë.

Një opsion i dytë sugjerohet nga vetë Kremli. Rusët kanë ofruar të lejojnë kalimin e sigurt të grurit dhe vajrave nga Ukraina dhe përmes Detit të Zi drejt Afrikës së Veriut dhe më tej, në këmbim të lehtësimit të sanksioneve ndaj saj. Është një formë shantazhi, e cila do të përshpejtonte humbjen vendimtare të Ukrainës.

Sanksionet, duke përfshirë edhe ato më të ashprat, kërkojnë kohë për të qenë efektive, madje edhe tani vendet evropiane importojnë ende gazin rus. Por problemi është që nëse Rusia e kontrollon bujqësinë ukrainase, drejtpërdrejt apo tërthorazi, ajo do të jetë në të njëjtin pozicion që ishte në lidhje me lëndët djegëse fosile: të mbajë peng Perëndimin dhe pjesën tjetër të botës. Sigurisht që kjo nuk do t'i jepte fund ambicies së Vladimir Putinit, për të reformuar perandorinë e vjetër sovjetike dhe ruse.

Opsioni i tretë është të krijimi i një korridor të sigurt për të

nxjerrë eksportet ushqimore nga Odesa, dhe për të thyer bllokadën ruse. Por kjo do të kërkonte një bashkëpunim ndërkombëtar të paprecedentë. Për të qenë efektiv, ky bashkëpunim duhet të mbështetet nga një “koalicion i vullnetarëve” globalë, jo i kufizuar tek NATO, dhe i mbështetur nga marina e shumë vendeve, edhe pse disa prej tyre mund të kenë vetëm një forcë simbolike.

Do të duhet një armatë e madhe mjeteshe për të fituar kontrollin e ujërave të Ukrainës dhe atyre ndërkombëtare, për të pastruar minat që gjenden aty, dhe për ta penguar marinën ruse tëfundosë anijet tregtare. Turqia, ruajtësja e hyrjes në Detin e Zi, dhe garantuesja e zbatimitKonventës ndërkombëtare të Montrosë, duhet të bindet të lejojë hyrjen e anijeve ushtarakepërmes Detit të Zi.

Deri më tani, presidenti Erdogan është shfaqur si një aleat i paqartë, sado të sinqerta që mund të jenë përpjekjet e tij për të siguruar paqen në rajon. Përballë presionit të kombinuar dhe stimujve miqësorë të

aleatëve të tij të NATO-s dhe fqinjëve të BE-së, Erdogan mund të nxitet ta zemërojë Kremlinin.


Megjithatë, nuk mund të jetë në interesin strategjik afatgjatë të Turqisë të ketë pranë një Rusi agresive, ekspansioniste, dhe që shkakton vazhdimisht telashe. Në fakt Ankarasë nuk i intereson as të ketë pranë një valë grushtesh shteti dhe akte dhune, si ato të Pranverës Arabe.

Tek e fundit, Rusia dhe Turqia janë tradicionalisht rivale të natyrshme me njëra-tjetrën.

Por deri më tani, 7 fuqitë e mëdha, nuk i kanë peshuar dhe analizuar këto zgjedhje të pakëndshme. Por pas çdo dite që kalon pa asnjë sinjal veprimi të vendosur, ka më shumë shanse që Rusia ta lërë botën të nënshtuar nga uria.

Askush nga ata që e shijoi peizazhin e bukur bavarez këtë javë, s'duhet të ketë asnjë dyshim mbi gatishmërinë e Vladimir Putinit për të sakrifikuar edhe më shumë jetë njerëzish, vetëmpër hir të projektit të tij megaloman.

|bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

'BUJOËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Kosova siguron medaljen e gjashtë në Lojërat Mesdhetare, Lorianana fiton të artën

Kosova e ka siguruar medaljen e gjashtë në Lojërat Mesdhetare dhe të pestën në sportin e xhudos. Lorianana Kukan e rrëmbeu medaljen e artë, pasi në finale e gjunjëzoi francezen Chloe Buttigieg

**EPOKA ERE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 1 KORRIK - Sportistët e Kosovës, konkretisht sporti i xhudos, si në çdo garë që merr pjesë, korrë suksese të mëdha. Xhudistja Lorianana Kuka e ka fituar medaljen e artë në Lojërat Mesdhetare "Oran 2022" që po mbahen në Algjeri. Ajo në finale e mposhti francezen Chloe Buttigieg në kategorinë deri në 75 kilogramë. Lorianana rrethin e parë e kaloi pa luftë, kurse në çerekfinale e mposhti xhudisten turke Nurcan Yilmaz në kategorinë deri -78 kg. E

suksesshme Kuka ishte edhe në gjysmëfinale, ku triumfoi ndaj kroates Petrunjela Paviq dhe në finale mposhti francezen Chloe Buttigieg. Kosova i kishte fituar edhe katër medalje të tjera në xhudo, dy të arta, me Distria Krasniqin e Laura Fazliun dhe dy të bronzta me Akil Gjakovën dhe me Flaka Loxhën. Ndërsa të bronztën e ka fituar edhe boksieri Shpëtim Bajoku.

Ndryshe nga xhudistja Kuka, xhudisti Shpat Zekaj është eliminuar nga Lojërat Mesdhetare, pasi ka pësuar humbje nga kroati Marko Kumriq me IPPON brenda

një minute. Zekaj në raundin e parë triumfoi ndaj italianit Enrico Bergamelli. Por, në çerekfinale u mposht nga nënkampioni i botës, Aleksandar Kukulj. Garat të premtën i përfundoi edhe Nexhat Sahiti në sportin e shenjëtarisë sportive, disiplina 10 metra pistoletë ajrore. Garuesi i Kosovës mblodhi 564 pikë, të cilat e renditën në vendin e 12-të prej 19 garuesve. Me pak fat, Sahiti ka mundur të hyjë në finale, ku u kualifikuan tetë garues. Garën nga afër e ndoqën edhe nënpresidenti i KOK-ut, Gazmend Maxhuni dhe anëtari i Bordit Ekzekutiv, Avni Nuha.

SHKURT

Ekow Mills përforcon Dritën

FC Drita e ka paraqitur të premtën transferimin më të ri, Ekow Mills. 19-vjeçari nga Gana ka nënshkruar kontratë katërvjeçare me skuadrën nga Gjilani. "Ekow Mills është lojtari më i ri i klubit tonë FC Drita, pasi tashmë ka nënshkruar kontratë katërvjeçare dhe do të jetë me ne deri më 30.06.2026. Ekow do të jetë i gatshëm për ndeshjet e Evropës dhe FC Drita i dëshiron mirëseardhje dhe suksese në fanellën e Dritës", thuhet në njoftimin Dritës. Ekow Mills luan në rolin e qendërmbrojtësit dhe është 19-vjeçar i lindur në Ganë, kurse Dritës i bashkohet pas një përvoje njëvjeçare në Spanjë, ndërsa formimin e tij si futbollist e ka bërë në vendlindje te FC Storm Academy.

Knowles i bashkohet KB Peja

KB Peja është duke vazhduar transferimet. Pasi zyrtarizoi trajnerin e ri, klubi pejan ka nisur përfundimet, ku ka siguruar shërbimet e Preston Knowles. Ky i fundit ka luajtur në Izrael, Kroaci dhe Greqi. "KB Peja njofton se ka nënshkruar me lojtarin amerikan Preston Knowles. Knowles, i gjatë 1.85 cm, ka një përvojë në liga të forta si ato të Izraelit, Kroacisë, Greqisë etj. Ai pritet t'i bashkohet trajnerit të ri të hënën ekipit në stërvitje", thuhet në njoftimin e KB Peja.

Kosovare Asllani nënshkruan me Milanin

Futbollistja me prejardhje nga Kosova, Kosovare Asllani, është transferuar te skuadra e Milanit. Asllani me Milanin ka nënshkruar kontratë dyvjeçare. "Krenare që i bashkohem AC Milanit në një marrëveshje dyvjeçare. Super e emocionuar për t'u transferuar në Itali", ka thënë Asllani. Ndryshe, Kosovarja më parë ishte pjesë e Real Madridit.

Abazi përforcon Ballkanin

Tashmë është zyrtare, Leonit Abazi ka nisur një aventurë të re në karrierë. Anësori, i cili e mbylli me Prishtinën, ka kaluar zyrtarisht te Ballkani i Ilir Dajës. Ish-futbollisti i Skënderbeut nis kështu një kapitull të ri në karrierë, duke lënë bardheblutë e kryeqytetit ku u shpall kampion i Kosovës për të kaluar te skuadra nga Suhareka. 28-vjeçari më parë ka qenë pjesë edhe e Dritës, ndërsa me Skënderbeun arriti të fitonte tre tituj kampioni dhe dy Superkupa të Shqipërisë.

Ramiz Bytyqin 'aterron' te Prishtina

PRISHTINË, 1 KORRIK - Ramiz Bytyqi është futbollisti i tretë që e përforcon skuadrën e Prishtinës në këtë afat kalimtar. Ai ka nënshkruar marrëveshje për tre vjetet e ardhshme me klubin

kryeqytetas. Mbrojtësi i djathtë është njohje e vjetër e trajnerit të ri të Prishtinës, Ismet Munishi, i cili e afirmoi Bytyqin në futbollin kosovar te skuadra e parë e Ballkanit. 23-vjeçari me

Ballkanin edicionin e kaluar e fitoi titullin kampion. "Të gjithë e dinë se Prishtina është klub i madh dhe pas bisedës me trajnerin Ismet Munishi vendosa t'i bashkohem ekipit.

Jam shumë i lumtur me këtë fakt. Synimet personale janë që të kem paraqitje sa më të mira me ekipin dhe t'i arrijmë objektivat që i ka klubi", ka thënë Bytyqi.



Piloti britanik i McLarenit: Shpesh kërcënohem me vdekje

LONDËR, 1 KORRIK - Në prag të garës së shtëpisë që zhvillohet këtë fundjavë në pistën e Silverstones, piloti britanik i McLarenit, Lando Norris, ka befasuar me deklaratën e tij. Ai ka pohuar se është viktimë e kërcënimeve dhe abuzimeve

përmes rrjeteve sociale. Në një intervistë për "Independent", piloti 22-vjeçar ka thënë: "Herë pas here marr mesazhe kërcënuese me vdekje. Mendoj se mesazhe të tilla në rrjetet sociale marrin shumë prej nesh dhe nuk bëhet asgjë për t'i

parandaluar ato. Në vitin 2019, kur hyra në Formula 1, ato mesazhe ishin paksa problematike për mua, por tani qesh. Nuk qesh nga një kërcënim me vdekje, por nga komentet që njerëzit shpikin dhe gjërat që bëjnë për ta tërhequr

vëmendjen. Unë dua të udhëtoj në botë, të garoj dhe të takoj njerëz të rinj, duke provuar përvoja të reja. Ndërsa të tjerë kalojnë jetën pas një kompjuteri, duke shkatërruar, bezdisur apo keqtrajtuar të tjerët me mesazhe të tilla", ka deklaruar Norris.



Pefqeli: Duhet ta rikthejmë titullin te Prishtina

PRISHTINË, 1 KORRIK - FC Prishtina dhe futbollisti Mërgim Pefqeli e kanë gjetur gjuhën e përbashkët për të nënshkruar kontratë të re dyvjeçare. Prishtina dhe Pefqeli janë "dashuri e vjetër" pasi që mesfushori sulmues edhe më herët ka qenë pjesë e skuadrës kryeqytetase ku i numëron 75 paraqitje në fanellën "bardhekaltër" teksa i ka realizuar 12 gola. Pefqeli në edicionin e fundit ishte pjesë e FC Malishevës me ç'rast tregoi paraqitje të kënaqshme duke dhënë kontribut të madh për sigurimin e një "bilete" të këtij ekipi për Superligë edhe për edicionin e ardhshëm. "Fakti që jam fëmijë i këtij klubi dhe kontaktet me trajnerin Ismet Munishi nuk më kanë bërë që të mendoj shumë për rikthimin te skuadra amë. Bartja e fanellës së Prishtinës, përveçse është privilegj dhe krenari e madhe, në



vete bartë përgjegjësinë e arritjes së rezultateve kulminante, pra trofeve. Synimet me Prishtinën janë që të rikthehem bashkërisht te titulli kampion si dhe garat evropiane. Prishtina e ka vendin aty përgjithmonë", ka thënë Pefqeli. "Tifozëve besnik të Prishtinës, 'Plisave', si gjithmonë u premtoj angazhim maksimal

dhe dhënien e atomit të fundit për ngjyrat 'bardhekaltër'. Bashkë me shokët e skuadrës do të bëjmë që të mburren me sukseset tona të përbashkëta. Hajde Prishtinë!", ka shtuar Pefqeli. 28-vjeçari gjatë karrierës së tij është aktivizuar edhe për Llapin, Trepçën '89, Trepçën, Hajvalinë e Fushë-Kosovën.

Kosova U20 fillon përgatitjet, Kabashi vlerëson grupin

PRISHTINË, 1 KORRIK - Përfaqësuesja U20 e Kosovës në hendboll ka nisur të hënën përgatitjet për Evropianin e muajit të ardhshëm. Nën urdhrat e kryetrajnerit Taib Kabashi janë 20 hendbollistë. Kabashi ka vlerësuar fillimin e përgatitjeve, ndërsa pranon se grupi në Kampionatin Evropian është i fortë. Kosova U20 prej 16 deri më 24 korrik luan në Evropianin e Divizionit B në Bullgari. "Kemi filluar përgatitjet dhe jemi vendosur në Gjakovë. Në grumbullim janë 20 lojtarë, 18 të klubeve të vendit dhe dy të klubeve të huaja. Ardin Berisha luan në Zvicër, ndërsa Ajdin Gashi nga Bosnjë-Hercegovina. Ndërkohë Frilon Kqiku e Oltion Rrecaj nuk kanë mundur të vijnë për shkaqe të ndryshme, punë dhe shkollim. Në këtë tubim për herë të parë kemi ftuar lojtarë si



Egzon Vuçitërna, Granit Kadiri, Altin Cacaj, Olsi Mulaj, Amar Muqolli, Eris Brahusi, Agon Bytyqi. Grupi është shumë i fortë, me Rumaninë, Zvicrën, Ukrainën e Maqedoninë e Veriut. Synimet e kombëtares sonë janë të paraqitemi sa më mirë në këtë

evropian", ka thënë Kabashi. Kosova po ushtron dy herë në ditë dhe do të përpiket ta shfrytëzojë maksimalisht grumbullimin, me synim për paraqitje sa më të mira në Evropianin në Bullgari, ndonëse grupi vlerësohet shumë i fortë.

SHKURT

Maldini, besnik i Milanit

Paolo Maldini, kontrata e të cilit si drejtor teknik i Milanit skadonte sot, ka vendosur të rinovojë për dy vjet të tjera, duke i dhënë fund një telenovele që mbajti në ankth tifozët kuqezi përgjatë gjithë muajit qershor. Legjenda e Milanit do të vijojë të merret me aspektin sportiv të klubit, së bashku me drejtorin sportiv Frederic Massara. Pas arritjes së marrëveshjes, Maldini ka thënë se: "Pritëm deri në fund, por erdhi rinovimi. Jemi pak vonë me merkaton, por do të rekuperojmë. Jam shumë i lumtur".

Duranti kërkon largimin nga Brooklyn Nets

Basketbollisti i Brooklyn Netsit, Kevin Durant, kërkon largimin nga ekipi i tij. Pas hapjes së merkatos edhe në basketboll, Duranti ka kërkuar të ndryshojë ambient. Sipas asaj që raporton 'The Athletic', 33-vjeçari dëshiron të largohet pas tre sezonesh te Brooklyn Nets. Drejtuesit e Netsit janë duke punuar për t'i gjetur një destinacion yllit të tyre. Miami Heat dhe Phoenix Suns janë dy opsionet e mundshme për basketbollistin. Mbetet të shihet se cila do të jetë e ardhmja e tij.

Superkupa e Italisë më 18 janar do të luhet në Arabinë Saudite

Seria A ka shpallur zyrtarisht datën e Superkupës së Italisë mes Milanit dhe Interit. Kampionët e Italisë do të ndeshen me fituesit e Kupës, më 18 janar 2023 në Riad të Arabisë Saudite. Ora e kësaj ndeshjeje do të vendoset në marrëveshje me organizatorët vendas. Kjo është përballja e tretë e konfirmuar me datë për sezonin e ri mes Milanit dhe Interit, pasi në Serinë A do të ndeshen më 4 shtator për javën e pestë dhe më 5 shkurt për javën e 21-të të kampionatit.

Belotti largohet nga Torino pas 7 sezonesh

Pas 7 sezonesh dhe 251 paraqitjesh në total në të gjitha kompeticionet, Andrea Belotti nuk është më futbollist i Torinos. Nga dita e premte kampioni i Evropës me Italinë është një lojtar i lirë dhe mund të transferohet te çdo skuadër me parametra zero. Klubi "granata" me anë të disa postimeve në profilin e tyre të rrjetit social "Twitter" ka përhëndetur në mënyrën e duhur kapitenin e skuadrës: "I dashur Andrea, marrim parasysh vendimin tuaj për të nisur një përvojë të re, që nga sot trugët tona ndahen. Kemi jetuar së bashku për shtatë sezone, të cilat në futbollin modern përfaqësojnë një lidhje shumë të fortë, duke ndarë gjithmonë gëzimet dhe vuajtjet, emocionet dhe zhgënjimet me të njëjtin pasion. Ju falënderojmë për gjithçka që na keni dhënë. Krenarë me kontributin e gjithë asaj që jeni bërë për skuadrën dhe ju përhëndesim me një fat të madh për vazhdimin e karrierës suaj".

15 lojtarë do të largohen nga Unitedi

Klubi anglez Manchester Unitedi pritet të ketë një eksod lojtarësh gjatë afatit kalimtar të verës. "Djajtë e Kuq" synojnë ta ndryshojnë organikën e skuadrës pas ardhjes së trajnerit të ri Erik ten Hag. Ekipi nga "Old Trafford"

dëshiron të përforcohet për t'u kthyer konkurrues në Ligën Premierë dhe garat evropiane, por fillimisht duhet të largojë disa lojtarë të padëshiruar. Sipas mediumit "Manchester Evening News", deri në 15 lojtarë të ekipit të lartë mund të

largohen nga Manchester Unitedi këtë verë. Lojtarët si Paul Pogba, Nemanja Matiq, Edinson Cavani, Jesse Lingard dhe Juan Mata tashmë janë larguar si lojtarë të lirë, por lista do të mbushet edhe më shumë emra të tjerë që pritet

të largohen. Eric Bailly, Phil Jones, Andreas Pereira dhe Anthony Martial do të jenë vetëm disa nga emrat e tjerë që janë në shitje ose mund të largohen si lojtarë të lirë. Përveç tyre, largimin rrezikojnë edhe Aaron Wan-

Bissaka, Axel Tuanzebe, Alex Telles, Brandon Williams, Andreas Pereira dhe Tahith Chong. Disa nga ta mund të huazohen, por shumica synohet të shiten për të krijuar fonde për ndonjë transferim të ri.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "DHF Company" Sh.p.k. Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Stacionin e karburanteve në Z.K. Llazicë, Malishevë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 25.07.2022 në ora 10:00, në Restorantin "Tali", i cili gjendet në afërsi të lokacionit të pikës së karburantit në segmentin rrugor Llozicë - Pejë në anën e djathtë të ketij aksi rrugore do të organizohet debat publik nga Kompania "DHF Company" Sh.p.k. Pejë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Stacionin e karburanteve në Z.K. Llazicë, Malishevë edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Platforma ZOOM Linku:
<https://us04web.zoom.us/j/>

71771074718?

pwd=kPxnUe9MGRmNXRLXqozNI

DTQcyld8_1

Meeting ID: 71771074718

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "DHF Company" Sh.p.k. Pejë për stacionin e karburanteve në Z.K. Llazicë, Malishevë

https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Kemal Ramizagic shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

► Jasin Vermica shpall te pavlefshme dëftesën e kl. X. Q.K " 11 Marsi " Prizren.

► Ermal Begu shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e SHMLM " Xheladin Deda".

► Mirlinda Gerguri shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHMLM " Dr Xheladin Deda".

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të

volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

